



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBETARE E PUNESIMIT DHE AFTESIVE TIRANË
SHKOLLA E MESME TREGTARE VLORË

Nr. 230 Prot

Vlorë , më 12.03.2024

Lënda: Njoftim për vend të lirë .

Drejtorisë së Burimeve njerëzore

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të udhëzimit nr 14 datë ,27.05.2021, “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e mesme Tregtare Vlore , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin e punës :

Specialist Finance

Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë të punës si vijon:

- a)të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b)të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryej detyrën
- c)të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d)të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- e)të demonstrojë vlera të larta të etikës ,sjelljes dhe komunikimit
- f)të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme për specialistë finance në ofruesit e AFP-së si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë të nivelit bachelor në shkencat ekonomike ,sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës .
- b) të ketë të paktën 3(tre)vjet përvojë pune në pozicione të ngjashme , sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës .
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit për vendin e lirë të punës , duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën + listën e notave ;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.
- l) të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës , 27.03.2024

DREJTORE
Gjenovefa Xhakaj

Gjenovefa Xhakaj

[Signature]